



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-12954 /2025

Datë: 30.04 /2025

Duke u bazuar në nenin 17 në shkronjën n) dhe r), nenin 40. paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040, Ligjin Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, nenin 2,3,4 të ligjit Nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal, nenin 40 pikën 3) të Statutit të Komunës, me Propozimin e Kryetarit të Komunës nr. prot. 01-Nr.06-8532/2025 të datës:27.03.2025, me rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 07.04.2025, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur me datën: 25.04.2025 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 15,000.00 euro (pesëmbëdhjetëmijë euro) për Bashkësinë Islame në Klinë.
2. Mjetet buxhetore ndahen, bazuar në kërkesën e Bashkësisë Islame në Klinë me anë të së cilës kërkojnë financim në vlerë prej 15,000.00 euro (pesëmbëdhjetëmijë euro) për blerjen e një veture e cila do të shërbente për shërbime të cilat kryhen nga BIK.
3. Mjetet buxhetore si në nenin 1 të këtij vendimi do të ndahen nga Zyra e Kryetarit nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, fondi burimor (10), kodi i programit (160), nën programi (16018), kodi funksional (0111).
4. Për zbatimin e vendimit obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Bashkësia Islame në Klinë;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Fadil Gashi